

**VENDIM**  
**Nr. 191, datë 6.6.2023**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR MARRJEN E  
AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË  
BARRËS SIGURUESE) TË ASETVE TË PALUAJTSHME TË CENTRALIT  
FOTOVOLTAIK “BLUE 1” NË FAVOR TË “GREEN FOR GROWTH FUND  
SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF”**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 168, datë 31.7.2025)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, germa “b”, dhe nenit 10 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/6 prot., datë 1.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 7.4.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1135/2 prot., datë 14.4.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje, ndërsa me shkresën nr. 1135/3 prot., datë 18.4.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/4 prot., datë 11.5.2023, depozitoi në ERE dokumentacionin plotësues.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi është plotësuar tërësisht si vijon:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”:

Pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, plotësuar;

Pika 3: plotësuar;

Pika 6: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. *Dhënia e autorizimit për vendosjen e një barre të re siguruese mbi asetet fikse të centralit fotovoltaik 'Blue 1', në favor të 'Banka e Parë e Investimeve – Albania' sh.a. dhe 'First Investment Bank AD' (Bullgari), në kuadër të marrëveshjes të huas, për qëllime rifinancimi të detyrimeve ekzistuese ndaj 'Green for Growth Fund – Southeast Europe S.A., SICAV-SIF' (lista e asetëve bashkëlidhur).*

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**

#### ANEKSI 1

#### LISTA E ASETËVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, TË CILAT VENDOSËN BARRË SIGURUESE NË FAVOR TË “BANKA E PARË E INVESTIMEVE – ALBANIA” SHA DHE “FIRST INVESTMENT BANK AD”

*(zëvendësuar me vendimin nr. 168, datë 31.7.2025)*

1. Panel diellor, me vlerë 27,467,324.72 euro;
2. Inverter, me vlerë 2,027,656.35 euro;
3. Transformatorë, me vlerë 2,035,961.53 euro dhe 801,921.72;
4. Pilota dhe struktura, me vlerë 8,941,567.37;
5. Kabllo dhe aksesore (pajisje LV) + Scada + Sistem CCTV, me vlerë 1,087,192.72;

**Në total rezultojnë 42,361,624.40 euro (ose 4,144,661,331 lekë).**